



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 136/3 Prot.

Tiranë më 14.2.2020

VENDIM

Nr. 03, datë 14.2.2020

PËR KONTROLLUESIN "KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Kolegji Universitar LOGOS",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.12 datë 24.01.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 29.01.2020 u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Kolegji Universitar LOGOS" me objekt:

- Zbatimit të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Kolegji Universitar Logos", konstaton se:

1. Kontrolluesi "Kolegji Universitar LOGOS", më datë 28.01.2020, ka "Njoftuar" për herë të parë Zyrën e Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

"Njoftimi" mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat kontrolluesi është përgjegjës, është një detyrim ligjor i rëndësishëm pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi kategorinë e të dhënave që përpunohen, qëllimin e përpunimit të tyre, realizimin e detyrimeve ligjore nga ana e kontrolluesit etj.

Kontrolluesi Kolegji Universitar LOGOS, edhe pse ka vite që ushtron aktivitetin e tij në fushën e arsimit të lartë, ka përmbytur detyrimin për "Njoftimin" pranë Zyrës

së Komisionerit më datë 28.01.2020. Njoftimi është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore që duhet të përmbush kontrolluesi përpara se të përpunojë të dhëna për herë të parë. Ndërkohë, rezulton se kontrolluesi është vënë në lëvizje për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor vetëm pasi është njohur nëpërmjet Urdhrin e inspektimit nr.12, datë 24.01.2020 të Zyrës së Komisionerit, për zhvillimin e hetimit administrativ.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar: "...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë".

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "d", të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

2. Kontrolluesi ka hartuar rregulla specifike "Për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale" në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Konstatohet se kjo rregullore është sipas modelit standard të marrë nga faqja zyrtare e Komisionerit www.idp.al, megjithatë përmbajtja e saj është e përgjithshme dhe nuk reflekton detyrimet ligjore sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon kontrolluesi (deklaruar në formularin e njoftimit).

3. Kontrolluesi ka nënshkruar me punonjësit "Deklaratë Konfidencialiteti", në zbatim të nenit 28, ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 6/2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale".

Gjithashtu, në pikën 1, 2 dhe 3, të nenin 20, të Kontratave individuale të punës është parashikuar ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi CCTV dhe informon nëpërmjet tabelave informuese për prezencën e këtij sistemi, në zbatim të nenit 18, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.3 datë 05/03/2010, të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".
5. Kontrolluesi ka vendosur Politikën e Privatësisë në faqen zyrtare të internetit www.kulogos.edu.al, në zbatim të nenit 18, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Në zbatim të neneve 87-89, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi "Kolegji Universitar LOGOS" është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore në datën 11.02.2020, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Përfaqësuesi i kontrolluesit është paraqitur në seancën e caktuar dhe nuk ka shfaqur asnjë kundërshtim lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ. Ndërkohë, sqaroi se Formulari i Njoftimit është plotësuar dhe depozituar në momentin që janë vënë në dijeni të Urdhrit të inspektimit, kjo për faktin se nuk ishte në dijeni të këtij detyrimi ligjor. Gjithashtu, përfaqësuesi i kontrolluesit pretendoi se ka bërë ndryshimet e nevojshme tek rregullorja specifike "Për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale".

Lidhur me pretendimin e përfaqësuesit të Kontrolluesit për mosnjohjen e detyrimit ligjor për "Njoftim", theksojmë se mosnjohja e ligjit nuk përbën shkak për përjashtim nga detyrimet që rrjedhin prej tij. Kontrolluesi duhet të kishte marrë masa për zbatimin e detyrimeve ligjore që në momentin e përpunimit të të dhënave personale për herë të parë.

Përsa i përket, rregullores specifike "Për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale" edhe pse kontrolluesi pretendon se ka kryer ndryshimet e nevojshme, nuk ka paraqitur asnjë provë materiale për të mbështetur këtë fakt. Për rrjedhojë, lihet si detyrë ndryshimi i kësaj rregullore duke përshtatur atë me kategorinë specifike të të dhënave personale që përpunon kontrolluesi.

Si përfundim, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të hetimit administrativ konsiston në mungesën e "Njoftimit" të Zyrës së Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale. Mos përmbushja në kohë e këtij detyrimi, në kuptim të gërmës "d", të pikës 1, të nenit 39, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë:

- d) "Kontrolluesit që nuk përmbush detyrimin për të njoftuar sipas përcaktimit të nenit 21 të këtij ligji, dënohen me 10.000 deri në 500.000 lekë";

Kontrolluesi "Kolegji Universitar LOGOS", në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar, është person juridik dhe sipas nenit 39/2, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, për kundërvajtjen e mësipërme dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze. Ajo lidhet me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Megjithatë, është marrë në konsideratë fakti që kontrolluesi është treguar bashkëpunues me grupin e kontrollit, ka reaguar pas konstatimit të shkeljeve si dhe ka përmbushur detyrimet për kërkesat ligjore, duke ndikuar në përcaktimin proporcional të masës së sanksionit.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 21, 29, 30, 39 pika 1, gërmat "d", si dhe nenet 40 dhe 41 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Kolegji Universitar LOGOS", me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 21, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
2. Kontrolluesi "Kolegji Universitar LOGOS", të realizojë përshtatjen e rregullores specifike "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" në përputhje me aktivitetin e ushtruar, brenda një periudhe prej 30 ditësh nga marrja dijëni. Përbushja e këtij detyrimi përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbaramit.
4. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 14.2.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

